



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 32/08

Prishtinë, më 01.12.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Naser Osmani, Riza Smaka.

Anëtarët jo të pranishëm: Besa Gaxherri, Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Behxhet Haliti, Nashide Bajrami, Orhan Devaja nga MEF-i, Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Haki Shatri, nënkryetar i parë i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 10 , 13 dhe 19 nëntor 2008**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Individuale**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin e Normës së Akcizës**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 10 , 13 dhe 19 nëntor 2008

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalit nga mbledhjet e 10, 13 dhe 19 nëntor 2008 miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Individuale

Kryesuesi, kërkoi shpjegime nga përfaqësuesit e MEF-it lidhur me Projektligjin në fjalë.

Behxhet Haliti, njoftoi se ky projektligj ka ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut, duke mos prekur përmbajtjen, më përjashtim të emrit dhe normave tatimore. Ky ndryshim është bërë si rezultat i vendimit të Qeverisë për të ndryshuar normat tatimore dhe në këto ndryshime është bazuar edhe buxheti.

Myrvete Pantina, theksoi së është dashur të precizohen të ardhurat vjetore dhe shkallët tatimore të aplikuara për ato.

Kryesuesi, ndryshimet janë të qarta. Janë ndryshuar normat tatimore nga 5-4 %, nga 10-8% dhe nga 20-10%.

Riza Smaka, kërkoi që neni 29 të riformulohet, si dhe neni 14 të precizohet.

Gani Koci, theksoi se të bëhen ndryshimet e mundshme teknike. Kërkoi që me modifikimet e mundshme në bashkëpunim me MEF-in të miratohet ai kur dihet se do të vie versioni i ri. Kërkoi që Rregulloret të inkorporohen në ligj nëse është e mundur (Rregullorja 2007/23). Të thuhet se me këtë ligj ndryshohen të gjitha aktet që rregullojnë këtë fushë.

Nashide Bajrami, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se Rregullorja 2007/23 ka përcaktuar më saktë vetëm Njësitë e Përhershme me qëllim të identifikimit të tyre dhe si e tillë nuk ka efekte tjera juridike.

Safete Hadërgjonaj, duke komentuar Projektligjin theksoi se ka hapësirë për ndryshime. Në lexim të parë të kalojë kështu dhe më pas Komisioni të bëjë disa ndryshime që të bëjnë Ligjin funksional dhe të zbatueshëm, deri në nxjerrjen e ligjit të ri që do të ndryshojë këtë.

Kryesuesi, kërkoi që të bëjë një rekomandim Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis për shqyrtim në seancë plenare dhe në mes leximit të parë dhe të dytë komisioni të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Individuale dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

Kryesuesi, kërkoi shpjegime nga përfaqësuesit e MEF-it për këtë projektligj.

Behxhet Haliti, theksoi se sikurse me ligjin paraprak, ndryshimet e vetme kanë të bëjë me emrin dhe normën tatimore nga 20-10%. Është propozuar që të mbesin në fuqi dy Rregulloret e UNMIK-ut (Rregullorja për rregullimin e aseteve dhe Rregullorja për Njësitë e Përhershme), deri në nxjerrjen e ligjit të ri.

Gani Koci, bërë vërejte dhe kërkoi të jenë më të kujdesshëm me neni 6 që rregullon OJQ-të, kur nga praktika dihet se shumë prej tyre në emër të bamirësisë janë shëndrruar në mikroorganizata duke iu shmangur tatimeve. Prandaj duhet definuar qartë roli dhe aktiviteti i OJQ-ve.

Hajdin Abazi, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit theksoi se edhe në kuadër të Komisionit për Media është duke diskutuar për Ligjin për asocimin e OJQ-ve me qëllim të definimit të tyre. Qëllim ka të bëjë me definimin vërtet të aktivitetit të OJQ-ve dhe me identifikimin më të lehtë të OJQ-ve që ushtrojnë aktivitete përfundim më qëllim të aplikimit të tatimeve.

Kryesuesi, këto çështje do të duhej merren parasysh pas leximit të parë.

Riza Smaka, theksoi se duhet bërë harmonizimi me Ligjin për organizatat biznesore. Duhet definuar se çka quajmë korporatë biznesore. Gjithashtu kërkoi që të bëhet harmonizimi i gjuhëve.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se ka refleksione në Ligjin për TVSH. Duhet punohet shumë në këtë ligj se ka nevojë për modifikime. Rasti i OJQ-ve të definohet qartë me kritere se cilat veprojnë për qëllime bamirësie, e cilat për qëllime profitabile.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Kryesuesi, kërkoi shpjegime nga përfaqësuesit e MEF-it nëse kanë diçka që nuk është paraparë në projektligj.

Behxhet Haliti, theksoi se është e njëjta procedurë dhe të njëjtat ndryshime që kanë të bëjë me emrin dhe me normat tatimore. Rregulloret tjera nuk janë inkorporuar në këtë projektligj.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se ekziston letra shpjeguese nga MEF-i për këto Projektligje. Prandaj të shikohen mundësitë e ndryshimit dhe të kalojnë me procedurë të shpejtë.

Gani Koci, kërkoi që Rregullorja 2004/35 të inkorporohet në këtë ligj me ndryshimet e veta.

Safete Hadërgjonaj, kërkoi që të fshihen termat RFJ dhe termat e ngjashëm.

Riza Smaka, theksoi se duhet bërë disa ndryshime. Neni 12.1 alineja 4 nuk ka arsyeje ligjore të përjashtohet lizingu nga tatimi. Neni 28 të ndryshohet sepse nuk janë të qarta dispozitat ndëshkimore. Po ashtu edhe neni 29 që ka të bëjë me ankesën në kufijtë juridik. Neni 31 të thuhet se të gjitha dispozitat e tatimeve që janë në kundërshtim me këtë ligj do të shfuqizohen.

Gani Koci, propozoi që edhe përfaqësuesit e zyrës ligjore të MEF-it të punojnë për të sjellur ndryshimet nga vërejtjet e bëra. Pastaj së bashku me Komisionin të bëjë amendamentet e nevojshme.

Naser Osmani, duke u ndërlidhur, theksoi se pas prezantimit të Ligjeve në Kuvend, deputetet duhet të merren me këto projektligje të propozuara çfarëdo që të jenë ato, dhe se Ministria nuk duhet të përzihet më.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me nëntë vota PRO dhe një KUNDËR (z. Naser Osmani) njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Tatimin e Normës së Akcizës

Behxhet Halit, edhe më këtë projektligj janë bërë ndryshimet që kanë të bëjnë me emrin dhe normat tatimore. Është arritur neutraliteti i normave tatimore. Norma e duhanit është ngritur nga 17-21 € Janë bërë ca sqarime në lirimet nga mazuti, disa definicione më të karta më qëllim të shmangies së paqartësive që kanë ndikuar në evazionin fiskal.

Naser Osmani, pyeti se a kanë konsultuar çmimet se sa është akciza në kafe dhe verë në vendet e rajonit dhe të BE-së, me rastin e përcaktimit të shifrave të reja.

Nashide Bajrami, duke iu përgjigjur theksoi se në vendet e BE-së nuk aplikohet akciza për verën e tavolinës, ndërsa në krahasim me vendet e rajonit jemi ne mesin e tyre. Në rastin tonë do të shkaktonte problem buxhetor nëse hiqet akciza, për shkak se duhet bërë si për importuesit po ashtu edhe për eksportuesit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji për Tatimin e Normës së Akcizës dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve lidhur me projektligjet për ndryshimin e normave tatimore, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- I. Kërkohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, zyra ligjore që vepron pranë kësaj Ministrie, duke pasur parasysh vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të Komisionit, të bëjë spastrimin e tri Projektligjeve: Projektligjin për TVSH, Projektligjin për Tatimin

në të Ardhurat Individuale dhe Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe versionet e spastruar t'ia dërgojë Komisionit.

- II. Komisioni me rasti e amendamentimit të këtyre ligjeve do të punojë në bazë të versionit të teksteve të spastruara.

7. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Haki SHATRI